

Të nderuar qytetarë,

E kam pritur si sfidë rikthimin në drejtimin e Komisionit Parlamentar të Shëndetësisë, që është fusha ku qeveria e Edi Ramës ka dalë zbuluar që ditën e parë në pushtet. “Shëndetësia falas” rezultoi mashtrimi dhe dështimi më i madh i Edi Ramës, që jam e sigurt se do e përndjekë atë gjithë jetën për dëmin dhe koston e madhe humane që ka shkaktuar dhe që u dëshmuar më së qarti gjatë periudhës së pandemisë. Meqenëse jemi te pandemia, ky Kryeministër ngjan aq shumë me COVID-in, njësoj si ai, është i pabesë, njësoj si ai, është shkatërrimtar dhe njësoj si COVID-i, i cili ndryshon emrat nga DELTA në MU, ai mund t’i ndryshojë emrat e qeverisë, por që qeveria “Rama 3”, ashtu si “Rama 1” dhe “Rama 2”, do të mbetet armiku kryesor i qytetarëve. Pandemia nxori në pah sesi e keni shkatërruar sistemin shëndetësor, ku vetëm ai që kishte, apo mund të gjente para, mund të shpëtonte jetën. Pronarët e kompanive të mëdha koncesionare, edhe në shëndetësi, por edhe deputetë e ministra nuk i besuan këtij sistemi shëndetësor shqiptar, por u hipën avionëve për t’u shëruar në vendet e tjera. Ndërkohë, shqiptarët u izoluan, u dhunuan dhe u denigruan nga një Kryeministër, i cili shfrytëzoi edhe fatkeqësinë më të madhe kombëtare për të grumbulluar më shumë pushtet në duart e tij dhe për të kontrolluar jetët e çdo shqiptari, duke shkelur në mënyrë të përditshme të drejtat kushtetuese e ligjore dhe për të urdhëruar apo lejuar tenderë sekretë, duke vjedhur edhe paratë e shëndetit të qytetarëve. Shifrat janë alarmante dhe tronditëse. Komisioni Europian ka konfirmuar që Shqipëria ka nivelin më të lartë të vdekshmërisë, jo në rajon, por në Europë, 27,1%, pra më shumë se dyfishi i nivelit të Bashkimit Europian.

Shikojeni këtë grafik, i cili është tronditës. Ja ku janë të gjitha vendet e Europës dhe shikojeni ku është niveli i vdekshmërisë në Shqipëri! Pyetja që më lind mua sot është: kush është përgjegjës për këtë numër rekord humbje jetësh në Shqipëri? Kush është përgjegjës për keqmenaxhimin e pandemisë? Edhe një jetë humane është e shtrenjtë, po mijëra jetë?! Kush është përgjegjës për humbjen e tyre?! Sigurisht ka vetëm dy emra: Edi Rama dhe Ogerta Manastirliu, të cilët nuk duhet të ishin sot në këto karrige dhe, aq më pak, të kërkonin votën e këtij parlamenti, por duhet të ishin para drejtësisë! Të dashur qytetarë, Edi Rama përsëri po tallet me ju. Ai nuk ka një program dhe nuk ka program as për shëndetësinë.

Ai vjen sot me këtë pa fletë mashtrimesh dhe gënjeshtërash, pasi në copën e letrës që lexoi sot nuk ka as kosto, as afate, as angazhime apo politika konkrete në interesin tuaj. Ky program që kemi sot përpara ka vetëm premtime të vjetruara e të pambajtura, që sot i riciklon me emra fancy, madje edhe në anglisht si “one health”, sa për të kaluar radhën. Programi i Edi Ramës për shëndetësinë garanton vetëm një gjë, e cila është e sigurt: pagesat për koncesionet e veta korruptive, për të cilat ka planifikuar deri tani në shëndetësi rreth 400 milionë euro, ndërkohë që sistemi shëndetësor është në pikë të hallit dhe njerëzit nuk marrin shërbimin për të cilin paguajnë shumë, shumë shtrenjtë. Shtylla kryesore, e të ashtuquajturit program i shëndetësisë, është riciklimi i premtimit: mbulim shëndetësor universal, të cilit nuk i ka vënë as paketim të ri dhe nuk është lodhur as për këtë. Ky është një premtim i vjetër, aq sa Rama është në pushtet, mashtrim i vjetër. Kush përplasat dyerve të spitaleve apo qendrave shëndetësore e di mirë se shqiptarët jo vetëm nuk marrin dot shërbim cilësor në sistemin shëndetësor publik, por vazhdojnë të paguajnë çdo ditë e më shumë në spitalet private. Nga xhepi i shqiptarëve dalin 80-90 milionë euro në vit për të paguar në spitalet private për shërbimet që nuk i marrin në

spitalet publike. Të nderuar qytetarë, Më lejoni t'ju njoh me një mashtrim tjetër të këtij, të ashtuquajturit, program të Edi Ramës, atë për autonominë spitalore. Dua që ta shikoni dhe ta dëgjoni. (vendoset videoja) Data është 27 janar 2015 dhe ky është Edi Rama i vitit 2015. Çfarë ndryshon me Edi Ramën e vitit 2021, pra, me Edi Ramën e sotëm?! Asgjë nuk ndryshon. Ai vetëm e ka ricikluar si premtim, domethënë, premtim mashtrim të tij. Të dashur qytetarë, Mashtrimet, në këtë të ashtuquajturin program, vazhdojnë. Mashtron me 600 mijë të pasiguarit, që edhe në qeverinë e Sali Berishës mund të siguronin shërbim shëndetësor falas vetëm nëse siguronin një vërtetim nga zyrat e punës; mashtron që check up-i është falas, i cili jo vetëm që nuk është falas, por i kushton buxhetit të shtetit 120 milionë euro nga taksat tona, pra, nga paratë tona. E paguajmë shumëfish check up-in e Vilma Nushit, që deri sot është paguar më shumë se 30 milionë euro, madje, për 500 mijë analiza të pakryera asnjëherë ka marrë më shumë se 7,5 milionë euro; mashtron me 300 qendrat shëndetësore, ku vetëm ditët e fundit kolegët e mi deputetë kanë denoncuar kushtet e mjerueshme të disa qendrave shëndetësore, jo në zonat rurale, por në ato urbane; mjekët jo vetëm nuk janë vlerësuar dhe respektuar, por u zhvlerësuan, u denigruan dhe u braktisën në betejën përballë COVID-it. A i mbani mend 1,2 milionë maska të skaduara prej 10 vjetësh, të cilat ua shpërndanë mjekëve dhe infermierëve të qendrave shëndetësore dhe ende sot ky krim i tmerrshëm nuk është hetuar. Një mikështime ime më tregoi sot që në 18 muaj pandemi vetëm 2 pako me maska kanë marrë dhe nuk bëhej fjalë për mjete të tjera mbrojtëse. Prej muajsh pjesa më e madhe e personelit mjekësor nuk merr as shpërblimin e COVID-it; 55 jetë të humbura, deri në muajin qershor, ndër mjekë e infermierë, që, me shumë gjasa, nëse do të ishin marrë masat e duhura në kohën e duhur, mund të ishin shpëtuar; bonusi prej 2,5 milionë lekësh ishte dështim. Mjekët e refuzuan bonusin, sepse ata e kishin të qartë që, pavarësisht këtij bonusi, nuk kishin kushte për të shërbyer.

Sot në qendrat shëndetësore në Tiranë nuk kishte as teste të shpejta, ndërsa për mjete mbrojtëse as që bëhej fjalë. Kjo është qeveria e mafies së ilaçeve. Nuk ka ilaçe të lira, jo, ka ilaçe të skaduara, të paefektshme, të pakontrolluara dhe të pasigurta, që u shiten shqiptarëve për të superpasuruar mafien e ilaçeve dhe ortakët e tyre në qeveri. Ka edhe shumë mashtrime të tjera, por koha nuk ma lejon. Prandaj, para se ta mbyll fjalën time dua të ndalem në atë që Edi Rama e quan si arritje të qeverisë së tij: numrin e grave në qeverinë "Rama". Sigurisht edhe unë e përshëndes rritjen e numrit të grave në qeveri, në parlament dhe në parti, pasi kam shumë vite që unë, bashkë me koleget e mia, luftojmë për këtë, sepse realisht besoj se gratë janë më të përkushtuara, më të pakorruptuara, më të dedikuara në pjesën më të madhe, por është shumë e shëmtuar dhe e turpshme kur gratë përdoren thjesht si statistikë, si numër apo si fasadë. Është për të ardhur keq që asnjë grua ministre apo asnjë deputete nuk ka folur për një nga fenomenet më negative të pandemisë, për rritjen e dhunës në familje dhe rritjen e dhunës ndaj grave. Ka mijëra raste të shtuara dhe dhjetëra gra të vrara nga burrat e tyre gjatë periudhës së pandemisë, por askush nuk foli për to, nuk u mor asnjë masë për t'i mbështetur dhe për t'i marrë ato në mbrojtje. Rritja e numrit të grave në qeveritë "Rama 1", "Rama 2" dhe "Rama 3" është në proporcion të zhdrejtë me përmirësimin e statusit të tyre ekonomik dhe social. Më shumë se 100 gra janë vrarë këto vite nga burrat. Urdhurat e mbrojtjes nuk po i mbrojnë ato, sepse shteti i ka braktisur, qeveria është bërë palë me dhunuesin dhe jo me të dhunuarën.

E, pra, vendi i parë në botë, për statistikë, që nuk mund t'i mbrojë dot gratë e thjeshta shqiptare, që janë braktisur edhe nga gratë e qeverisjes "Rama 1", "Rama 2" dhe "Rama 3". Së dyti, pjesë e këtij kabineti të propozuar nga "Rama 3" janë Ogerta Manastirliu dhe Ulsi Manja, për të cilët, personalisht, kam dorëzuar në SPAK 3 kallëzime penale për përfshirjen e tyre në krime elektorale. Ogerta Manastirliu dhe Ulsi Manja nuk duhej të ishin sot në karriget e ministrit, por duhej të ishin para drejtësisë. Ndaj, vota ime dhe e grupit parlamentar kurrsesi nuk mund të jetë për një qeverisje me personat që duhet të ishin ndëshkuar sot nga drejtësia që jam e sigurt se do të vonojë, por nuk do të harrojë.

